



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.40

Prishtinë, më 9.2.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të MKRS, KDI-së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Miratimi i rendit të ditës,

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 26.01.2016,

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016,

5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.1.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 26.1.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Nait Hasani, tha se Projektligji nr.05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, është proceduar në Kuvend dhe janë plotësuar kushtet për shqyrtim në parim. Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, ngase ofron bazë ligjore për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Komisioni, pas leximit të parë, do të organizojë dëgjim publik me grupet e interesit, si dhe do të respektojë afatet kohore për procedimin e tij për lexim të dytë.

Iber Alaj, drejtor i Departamentit të Sportit në MRKS, tha se Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ka për qëllim që të rregullojë mbështetjen financiare dhe materiale të aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore. Ky projektligj është me interes të veçantë në përmirësimin e jetës shoqërore të qytetarëve, të bizneseve, të personave fizikë dhe juridikë. Ky projektligj sjell disa lehtësira në aspektin financiar, që tatimi për vlerën e shtuar, nga 20% të zvogëlohet në 10%.

Feim Hoxha, drejtor i Departamentit Ligjor në MRKS, tha se projektligj ka për qëllim krijimin e kushteve më të mira për promovimin e sportit dhe aktiviteteve të tjera në fushën e kulturës e rinisë. Ky projektligj ka dy objektiva kryesore, sponsorizimin dhe donacionet, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira financiare për sportin dhe kulturën, përmes lehtësirave në tatim.

Bekim Haxhiu, tha se projektligji është i mirëseardhur. Me anë të tij pritet të rregullohet çështja e sponsorizimit dhe donacioneve, në veçanti, në fushën e sportit. Ai tha se ky projektligj nuk mbulon të gjitha objektivat, sidomos në këtë fazë kur vendi po tenton të thyejë të gjitha barrierat në kulturë dhe sport. Po ashtu, tha se ky ligj do të duhej t'i rregullojë dy çështje: atë të mbështetjes financiare për sportin dhe disiplinimin financiar të klubeve sportive. Me këtë rast, ATK-ja do të kontrollonte të hyrat dhe shpenzimet e klubeve sportive.

Salih Morina, tha se MRKS-ja ka bërë një punë të mirë me sjelljen e këtij projektligji, i cili rregullon aspektet e sponsorizimit dhe donacioneve. Pas miratimit në parim, do të organizojmë dëgjim publik, me qëllim të marrjes së informatave, sugjerimeve nga grupet e interesit, që së bashku të japim kontributin e tonë në këto fusha të rëndësishme, duke përfshirë edhe përfaqësuesit nga opozita.

Sergjen Popoviq, shtroi çështjen e regjistrimit të klubeve sportive në MKRS, ngase disa nga klubet sportive të komunitetit serb, janë të regjistruara si OJQ dhe kërkoi sqarim lidhur me regjistrimin e tyre në MRKS.

Mufera Shinik, tha se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka bërë një punë të mirë që e ka proceduar këtë projektligj. Po ashtu, e përkrahu në parim dhe do të japë kontributin gjatë fazës së shqyrtimit të tij.

Shpejtim Bulliqi, tha se projektligji është i mirëseardhur dhe do të jetë në interes për të gjitha çështjet që i mbulon, që për fat të keq, në veçanti sporti, nuk është në gjendje të mirë financiare. Ky ligj do të ndikonte në këtë aspekt dhe do të bëhet në interes të të gjitha komuniteteve, si dhe përkrahje në tërësi të sportit dhe kulturës në vend.

Iber Alaj, lidhur me çështjen e ngritur nga Sergjan Popoviq, tha se të gjitha klubet sportive në vend janë si OJQ, janë të licencuara nga kuvendet komunale, prej nga vijnë, funksionojnë në kuadër të federatave sportive, duke përfshirë klubet nga të gjitha komunat, pra edhe ato me shumicë serbe. MRKS-ja do të krijojë kushte të favorshme për të gjithë, duke synuar kështu promovimin sa më të madh të sportit në vend.

Anëtarët e Komisionit, pas debatit, theksuan se shqyrtimi dhe amendamenti i këtij projektligji kërkon një angazhim të veçantë, duke pasur parasysh rëndësinë e tij.

Pas diskutimeve, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr.05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji nr.05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016

Anëtarët e Komisionit propozuan që shqyrtimi i planit të punës për vitin 2016, të shtyhet për në mbledhjen e ardhshme, me qëllim të organizimit të një tryeze pune jashtë Kuvendit, ku do të jenë prezentë edhe përfaqësuesit e ministrive të linjës.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga: *Njësia për Mbështetjen e Komisionit*

Kryetari i Komisionit

Nait Hasani